



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
ëëë. avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602026/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin në shkollë të fëmijëve me incialet O.N dhe M. Z.*

Drejtuar: Znj. Arjola Byzyka
Drejtor i Drejtorisë Arsimore

Për dijeni: Znj. Lindita NIKOLLA
Minister i Arsimit dhe Sportit

Tiranë

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është dorëzuar ankesa e Matilda Nuredinit e cila pretendon drejtoresha e Shkollës "Siri Kodra" ju kane shkelur të drejtën fëmijëve të saj, me incialet O. N., datëlindja 14.04.2006 dhe M. Z., datëlindja 23.02.2010, të cilët nuk janë regjistruar në Shkollën "Siri Kodra" nga drejtoresha e shkollës pavarësisht se vendbanimi i tyre ndodhet pranë kësaj shkolle.

Në mbështetje të nenit 16 të Kushtetutës ku parashikohet se "*Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë*" si dhe pikës 3, të nenit 57, të Kushtetutës ku parashikohet se "*Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë*", dhe në zbatim të nenit 16, të ligjit 10347 datë 04.11.2010 "*Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*", ku parashikohet se "*Fëmija ka të drejtë të arsimohet në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor dhe fizik të tij.*", çdo

fëmijë, gëzon të drejtën për tu arsimuar, pavarsisht problematikës së paraqitur prej drejtoreshës së shkollës “Siri Kodra”, Tiranë.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për regjistrimin e fëmijëve O. N., dhe M. Z., në shkollën “Siri Kodra”, Tiranë.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brënda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI